



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-13-1261

Parashtruesi i Ankesës

G. S, i përfaqësuar nga Intertext..., përmes avokatit **B I** Prishtinë.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) – Autoriteti i Likuidimit (NSH “X.”, në likuidim), rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 10 mars 2020, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI066-0244 i datës 6 qershor 2013.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 korrik 2013, ankuesi pranë DHPGJS parashtron një kërkesë (të emërtuar padi) mbi rishqyrtimin e Vendimit nr. GJI066-0244 të datës 6 qershor 2013 (tani e tutje **VENDIMI**), lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (tani e tutje: **AL**).

Ankuesit me vendimin e kundërshtuar i është refuzuar kërkesa për paga të papaguara në shumë prej 20.000 (dy zero zero zero zero) Euro për periudhën nga viti 1999 gjer me 2007, ndaj NSH “X.”.

Ankuesi pohon se asnjëherë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se konsideron se i takojnë pagat për periudhën e lartëcekur.

Ankuesi propozon gjykatës që kërkesa e tij të aprovohet.

Kërkesës për rishqyrtim janë bashkangjitur:

- Kopje të formularit të kërkesës kreditore.
- Kopje të librezës së punës.
- Kopje të gjendjes bankare.
- Kopje të Vendimit.

Me 6 shkurt 2014, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin me të cilën ju kërkua që të parashtrij përkthimin në gjuhën Angleze të ankesës si dhe dokumentacionit të bashkangjitur.

Me parashtresën e datës 28 shkurt 2014, përfaqësuesi i ankuesit parashtrij përkthimin e ankesës dhe autorizimit për përfaqësim.

Bazuar në urdhërin e gjykatës AKP, me 24 prill 2014, parashtrij përgjigjen.

AKP e kundërshtoj ankesën duke e konsideruar si të pabazuar. AKP pohon se ankuesi nuk e ka argumentuar kërkesën e tij kreditore ashtu siç edhe parashihet me dispozitat e Shtojcës së Ligjit për AKP, Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve dhe Ligjit mbi punën e bashkuar. Nga gjitha arsyet e cekura, AKP propozoj që ankesa të refuzohet dhe vërtetohet vendimi.

Bazuar në urdhërin e gjykatës, ankuesi parashtrij përgjigje me 26 maj 2014.

Ankuesi i kundërshtoj pohimet e AKP, të dhëna në përgjigje, dhe njëherit mbeti në tërësi pranë ankesës.

AKP parashtrij kundërpërgjigjen me 25 korrik 2014.

AKP mbeti në tërësi pranë përgjigjes.

Me parashtresën e datës 27 gusht 2015, ankuesi bëri plotësimin e ankesës ashtu që kërkoj edhe kumatën ligjore duke filluar nga 1 dhjetor 2007 e gjer me datën e dorëzimit të parshtrësës, në shumë prej 7.700 (shtatë shtatë zero zero) Euro.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata konstaton se faktet relevante janë jokontestuese dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë.

Ankuesi, pohon se ishte punëtor i NSH gjerë në qershor 1999.

Bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parasheh, bazueshmërinë, e kërkesave për dëmshpërblim si rezultat nga ndërprerja e parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë

pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Nga dispozita e lartëcekur punëtori gëzon të drejtën në dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Nga ankesa nuk mund të shihet se ankuesi ka përmbushur njërin nga kushtet e parapara dhe kumulative ligjore, me qëllim që të gëzonte të drejtën në kompenzimin e të ardhurave personale.

Ankuesi, pavarësisht pretendimeve të tij, nuk ka arritur që të argumentoj se ka vazhduar punësimin duke filluar nga qershori i vitit 1999 e gjer me 2007, me çka do ti takonte edhe e drejta e kompenzimit e të ardhurave personale si rezultat i punës së tij. Gjithashtu ankuesi edhe përkundër saj, gjatë kësaj periudhe, asnjëherë nuk ka inicuar procedurë gjyqësore me të cilën do të kërkonte mbrojtjen ligjore dhe do ti adresonte kërkesat e tij.

Andaj ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi, fakt, apo ndonjë arsyetim ligjor që do të argumentonte dhe të dëshmonte bazueshmërinë e ankesës, ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086).

Barra e provave bie mbi ankuesin, që të dëshmoj se i njëjti ka plotësuar kushtet ashtu siç parashihen sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksën gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS palët i bartin vetë shpenzimet gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar